



ARRESTIMI POLITIK I LIDERIT TË OPOZITËS NË SHQIPËRI **SALI BERISHA**

Dosja e Klubit Partizani - një piramidë mashtrimi

Raporti ku zbardhet e
vërteta për procesin
politik të Klubit
Partizani me
faktet, provat dhe
dokumentat e
fshehura nga SPAK.



Arrestimi politik i Sali Berishës
Dosja e Klubit Partizani një piramidë mashtrimi
Raport i përditësuar

Përmbledhje Ekzekutive

Heqja e imunitetit të kryetarit të PD Sali Berisha, vendosja e tij në arrest shtëpie, ndalimi i çdo komunikimi me persona të tjerë, përveç atyre të familjes së ngushtë, si dhe arrestimi i dhëndrit të tij, Prof. Jamarbër Malltezi, ndërkohë që janë veç persona nën hetim, është vendim hakmarrës, tërësisht politik, i Edi Ramës. Ky vendim është marrë në dhunim të hapur të kushtetutës së vendit dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, nga prokurorë, gjykatës dhe parlamenti. Të kontrolluar totalisht nga Edi Rama.

Në prill dhe në maj të vitit 2022 Edi Rama i kërkoj publikisht SPAK të merrej me Sali Berishën non grata dhe prokurorët politik në zbatim të kërkesës së tij sajuan dosjen e Klubit Partizani.

Dosja e Klubit Partizani është tërësisht një piramidë mashtrimi politik, e cila, siç provohet nga dokumente zyrtare të renditura në këtë raport, bazohet në kallzimin e rreme të kryetarit të grupit parlamentar të Partisë Socialiste Taulant Balla, si dhe në shpifjen e fshehjen e qindra dokumentave, dhe manipulime nga prokurorë politikë.

Pas tre vitesh hetimesh shterruese, ata nuk kanë gjetur asnjë provë, fakt, dokument, apo ndonjë dëshmi të vetme, që të fajsojnë Sali Berishën dhe Malltezin.

Nga dhjetra zyrtarë të qeverive të djathta dhe të majta që kanë firmosur dokumentat e njohjes, kthimit të pronës dhe parablerjes së objekteve të klubit, të ndërhuara mbi këtë pronë, asnjë nuk është në ndjekje penale, sepse ata kanë zbatuar strikt ligjin.

Firma e Berishes nuk ekziston në asnjë vendim, urdhër apo dokument të këtyre proceseve dhe gjer sot, ai dhe Malltezi nuk janë pyetur asnjëherë të vetme, sepse kjo do rrëzonte piramidën e mashtrimit të prokurorisë politike të Ramës.

Ndryshimi i destinacionit, nga terren sportiv në zonë urbane, është bërë nga Edi Rama, veçmas nga privatizimi dhe pa kërkesën e pronarëve.

Ndërsa privatizimi i ndërtesave të rrënuara të klubit është filluar nga qeveria Nano dhe ka përfunduar nga qeveria Berisha. Ne këtë proces disa qindra pronarë, njëri prej të cilëve edhe Malltezi, morën pronën e tyre të konfiskuar nga komunistët 60 vite më parë.

Edi Rama i zhytur në skandale të mëdha, si ai i McGonigal dhe afera korruptive shumëmiliardëshe, për të shpëtuar veten me një mandat të ri, vendosi në arrest shtëpie kundërshtarit e tij politik, kryetarin e PD, Sali Berisha.

Së fundmi me keto masa pa asnjë baze ligjore ndaj kundërshtarit të tij politik Edi Rama provoj veten si djalë besnik i babait të tij Kristaq Rama i cili si zëvendës i Ramiz Alisë firmosi varjen publike me datën 10 gusht 1988 të poetit disident Havzi Nela për vargjet e tij kushtuar fjalës së lirë dhe të drejtave të njeriut.

Dosja Partizani piramidë mashtrimi politik

1. Heqja e imunitetit dhe vënia në arrest shtëpie e Kryetarit të PD Sali Berisha dhe Prof. Jamarber Malltezit, si persona nën hetim, me urdhër të Edi Ramës është një piramidë mashtrimesh politike e bazuar në kallzim të rremë, në shpifje, dhe fshehje të qindra dokumentave zyrtare.

1.1. Me datë 20 tetor GJKKO njoftoi se, me kërkesë të SPAK, kishte vendosur, pa miratimin e parlamentit, ndalimin e udhëtimit jashtë vendit, si dhe detyrim paraqitjeje në polici, të kryetarit të PD Sali Berisha dhe burgosjen e dhëndrit të tij Prof. Jamarbër Malltezi.

1.2. Këto masa u vendosën pa asnjë baze ligjore, pa ngritur padi penale, pa dhënë asnjë provë, fakt, apo dokument, por sepse Berisha është nën hetim për korrupsion pasiv, ndërsa Malltezi nën hetim për korrupsion pasiv dhe larje të produkteve të veprës penale, pa treguar si janë kryer këto vepra.

1.3. Berisha i refuzoi këto masa që vinin në kundërshtim të hapur me nenin 73§2 të Kushtetutës sipas së cilës ‘Deputeti nuk mund të arrestohet ose t’i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit’

1.4. Gjatë 32 viteve pluralizem këto masa nuk janë vendosur kurrë pa miratimin e parlamentit. Në vitin 2012 Berisha kërkoj abrogimin e nenit 73§2 të kushtetutës, por Edi Rama e refuzoi këtë në menyre të prerë dhe u arrit vetëm heqja e autorizimit për hetim.

1.5. Me datë 12.12.2023 prokurorët iu drejtuan parlamentit për zëvendësimin e masës së kundraligjshme të dates 20 tetor me masat heqje imuniteti, arrest në burg ose shtëpi, meqense Berisha nuk kish zbatuar urdhërin antikushtetues të gjykatës.

1.6. Ndryshe nga çdo precedent tjetër, kërkesa e paraqitur në parlament nuk u shoqërua me asnjë dosje me prova e fakte, por thjesht vetëm me vendimin antikushtetues së gjykatave të faktit e apelit.

1.7. Miratimi i këtij vendimi politik u njoftua mediatikisht me datën 14.12.2023, përpara çdo diskutimi në komisionin përkatës apo seancë plenare, nga kryetari i

grupit parlamentar të PS, Bledar Çuçi, i cili deklaroi se grupi i PS do të miratonte masat kundër Berishës.

1.8. Parlamenti, në kundërshtim me kushtetutën, votoi më 21.12.2023 për heqjen e imunitetit të Berishës dhe arrestin e tij në burg ose në shtëpi, pa paraqitur asnjë raport dhe pa i dhënë fjalën Berishës, i cili kërkoi të merrte fjalën pasi të largoheshin nga salla mbi 50 gardistë.

1.9. Me datë 30.12.2023, në kundërshtim të hapur me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutën, GJKKO vendosi arrest shtëpie për Berishën dhe ndërpreje të çdo komunikimi të tij si person i zgjedhur me votë me persona të tjerë, përveçse me familjarët e tij të ngushtë.

1.10. Masat e sigurisë janë vendosur nga prokurori Arben Kraja ish oficer i policisë sekrete hoxhiste, i larguar nga detyra në 1996 me ligjin e lustracionit dhe Enkeleida Millonai, e denoncuar nga Berisha për lidhje me krimin dhe abuzime me të drejtat e njeriut.¹

1.11. Masat u miratuan në konflikt të plotë interesi nga kryetarja e GJKKO Irena Gjoka, e shkarkuar nga detyra me 8 shkurt të vitit 1996 për paaftësi, nga ish-presidenti Sali Berisha, asokohe kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.²

2. Pas tre vjet hetimesh shteruese të kësaj çështjeje, rregjistruar pa emër të përveçëm, nuk është gjetur asnjë shkelje ligjore, fakt, provë, dokument, apo dëshmi e vetme nga dhjetra dëshmitarë të pyetur, që të fajsojnë Sali Berishën apo Jamarbër Malltezin.

3. Pa mundur të ngrenë akuzë ndaj tyre, me urdhër të Edi Ramës, prokurorët politikë, me datën 2 tetor 2023 nisën të njëjtin hetim ndaj Sali Berishes dhe Malltezit, dhe në një rast të paprecedentë i vunë ata nën masë sigurie që në fazë hetimi, pa i pyetur asnjëherë gjer sot.

4. Dosja e Klubit Sportiv Partizani është hapur pas një kallzimi të rremë të kryetarit të grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, i rregjistruar si kallzim penal

¹ [Aneksi 1: Pamja 1](#)

² [Aneksi 2: Pamja 2](#)

me datë 1.12.2020 dhe po atë ditë, është regjistruar procedimi penal nga prokurorja Millonai.³

5. Akuza kryesore e Taulant Balles bazohej në trillimin se toka nuk ju takonte pronarëve pasi sipas tij ajo ishte shpronësuar në vitet 1940 nga autoritetet italiane.⁴

6. Por, dokumentet e rregjistrave hipotekorë të viteve 1935, 1943, 1945 dëshmojnë se toka ka qenë pronë e familjeve pronare, ndër të cilat edhe familja Begeja e Jamarbër Malltezit.⁵

7. Fletoret Zyrtare të viteve '40, të fshehura nga prokurorët, provojnë se toka e Klubit Partizani nuk ka qenë kurrë e shpronësuar, por vetëm e rekuizuar (masë bllokimi e përkohshme), me dekret mbretëror të prillit 1942 dhe se, në qershor 1943 ky rekuizim u shty edhe 6 muaj të tjerë. Italia kapituloi në Shtator 1943.⁶

8. Prokurorët gënjejnë duke thënë se procesi i njohjes, kthimit të pronës dhe privatizimit të objekteve të ndërtuara mbi të ka filluar pas vitit 2005. Dokumentet provojnë se procesi ka filluar që në vitet 1995-1996.⁷

9. Sipas dokumentave zyrtare të firmosura nga Presidenti i Republikës, që në vitin 2004, Klubi i Futbollit Partizani NUK ka qenë në Planin e Përhapjes së Forcave të Armatosura. Ndonëse kjo del qartë në dosje, prokurorët u përpoqën në dhjetëra faqe të krijojnë konfuzion.⁸

10. Prokurorët pretenduan se toka e familjeve pronare nuk përfshinte gjithë sipërfaqen e ish Klubit. POR hartat zyrtare provojnë se tokat e 5 familjeve pronare shtrihen në atë zonë, në vazhdim të njëra-tjetrës, pa hapësira në mes, në sipërfaqe mbi 21 mijë m² më shumë se sipërfaqja e ish klubit, dhe përfshin edhe 1500 m² që grabiti Edi Rama me mikun e tij Carlo Bolino.⁹

³ [Aneksi 3: Pamja 3-4](#)

⁴ [Aneksi 4: Pamja 5](#)

⁵ [Aneksi 5: Pamja 6-9](#)

⁶ [Aneksi 6: Pamja 10-11](#)

⁷ [Aneksi 7: Pamja 12 - 13 - 13/1 - 13/2](#)

⁸ [Aneksi 8: Pamja 14-16](#)

⁹ [Aneksi 9: Pamja 17](#)

11. Ndryshe nga sa pretenduan prokurorët duke fshehur dokumenta, procesin e privatizimit të Klubit Partizani nuk e ka filluar qeveria Berisha.

11.1. Shkresat e firmosura nga ministrat socialistë Angjeli dhe Klosi dëshmojnë fillimin e procedurave të privatizimit të klubit në vitin 2005, për llogari të një subjekti tjetër që nuk kishte lidhje me pronën.¹⁰

11.2. Sipas dëshmisë së tij, ai u tërhoq nga procesi, pasi ligji nr. 9235 i datës 19.7.2004 i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në nenin 7§2 përcaktonte se pronat e paluajtshme që propozoheshin për tjetërsim ju kalonin të shpronsuarve; pra, ligji ia kthente pronën pronarit.¹¹

12. Prokurorët politikë pretendojnë se ligjet dhe vendimet e qeverisë së PD, në zbatim të programit të saj në fushën e pronësive, janë bërë për të favorizuar Malltezin. Në të vërtetë ato reforma nuk kanë synuar kurrë një person të veçantë.

12.1. Ato reforma bënë të mundur që, në vitet 2006-2012, mbi 500 mijë pronarëve legjitim t'u kthehen 1,577,400,000m² tokë, pronë e tyre. Njëri prej tyre, Malltezi, me kthim prone mori 410 m² tokë të familjes së tij, të konfiskuar para 60 viteve.¹²

12.2. Prokurorët vendimin e qeverisë nr. 1638, datë 17.12.2008 “*Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes*”, që në përputhje me programin e saj vendos përdorimin e letrave me vlerë në procese privatizimi, në favor të të gjithë qytetarëve, e konsiderojnë favorizim për Malltezin.¹³

12.3. Vendimi nr. 1638 (nga i cili qytetarët Shqiptarë kanë përfituar mbi 40 milion €) doli vetëm një muaj pasi familjet pronare të klubit Partizani kishin paguar me para (**lekë në bankë**) 90% të vlerës totale. Për 10% e mbetur të vlerës, Prof. Malltezi i bie se ka përfituar nga letrat me vlerë gjithsej 64 euro.

¹⁰ [Aneksi 10: Pamja 18-19](#)

¹¹ [Aneksi 11: Pamja 20](#)

¹² [Aneksi 12: Pamja 21-tabelë](#)

¹³ [Aneksi 13: Pamja 22](#)

13. Pretendimi se Berisha favorizoi Malltezin me ndryshimin e destinacionit nga zonë sportive në banimi është trillim. Ne ligjin e urbanistikës qeveria qëndrore nuk kishte asnjë kompetencë për ndryshime të tilla.

13.1 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të datës 10.11.2006¹⁴, rrëzoi aktin normativ që lejonte prefektin të mblidhte KRRT. Ndërsa me vendimin e datës 21.12.2006 GjK¹⁵ ndaloi çdo ndryshim të vendimeve të KRRT nga qeveria, duke e bërë firmosjen e vendimeve të KRRT nga qeveria një akt formal.

13.2. Ndryshimi i destinacionit të një pjese të klubit Partizani, nga zonë sportive në zonë urbane, është firmosur nga Edi Rama në vendimin nr 132/j, datë 08.06.2006, të KRRT, madje pa kërkesën e pronarëve të tokës.¹⁶

13.3. Në vitin 2008, me studimin e Zonimit Funkcional të firmosur nga Edi Rama dhe 12 drejtorë të tij, e gjithë pjesa e klubit dhe më gjerë u shndërrua në zonë urbane. Ndryshimi i destinacionit u bë nga Edi Rama para privatizimit të ndërtesave të klubit. Ky dokument është fshehur nga Spak.¹⁷

13.4. Edi Rama në vitin 2008 ka firmosur lejen e sheshit dhe ka miratuar me kusht lejen e ndërtimit. Këto dokumente janë fshehur dhe prokurorët thonë se lejet e ndërtimit u dhanë vetëm nga Basha. Në fakt, ato janë dhënë nga Rama, Basha dhe Veliaj.¹⁸

14. Kur Edi Rama mësoi se njeri nga dhjetëra pronarët e tokës ishte Jamarbër Malltezi, ai refuzoi ta zbardhë lejen e ndërtimit edhe pas vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Edhe këto vendime gjykatash ishin fshehur nga SPAK.¹⁹

14.1. Prokurorët kishin fshehur 3 shkresat e kundraligjshme të Kryeinspektorit të Policisë Ndërtimore të Edi Ramës, të lëshuar në 2010, për bllokimin e punimeve, edhe pasi kishte dalë vendimi i formës së prerë nga gjykata.²⁰

¹⁴ [Aneksi 14: Pamja 23](#)

¹⁵ [Aneksi 15: Pamja 24](#)

¹⁶ [Aneksi 16: Pamja 25](#)

¹⁷ [Aneksi 17: Pamja 26-27](#)

¹⁸ [Aneksi 18: Pamja 28](#)

¹⁹ [Aneksi 19: Pamja 29](#)

²⁰ [Aneksi 20: Pamja 30-32](#)

14.2. Ata kishin fshehur vendimet e formës së prerë të gjykatave që ndëshkuan Edi Ramën për shpërdorim detyre dhe dëmin e shkaktuar me bllokimin e paligjshëm të punimeve, me mbi 320,000 euro!²¹. Pavarësisht sa më sipër, në mbi 20,000 faqe të dosjes, prokurorët nuk e përmendin asnjëherë emrin e Edi Ramës.

15. Ata kanë fshehur vendimin gjyqësor të formës së prerë lidhje me falsifikimin e pronësisë së pishinës, të cilën pesë familjet pronare u detyruara ta blinin meqenëse ajo ishte pjesë e Klubit Partizani.²²

16. Për të mbështetur shpifjen e Taulant Ballës se Jamarbër Malltezi hyri si investitor vetëm me 114 m² tokë dhe doli me 5,4 milion euro fitim, prokurorët kanë fshehur faktin se toka e trashëguar prej tij ishte 410 m² dhe jo 114 m².

16.1. Në funksion të kësaj shpifjeje, ata kanë fshehur mbi 20 kontrata të blerjes nga Malltezi edhe të mbi 2100 m² tokë nga pronarët e tjerë, gjë që provon se Malltezi ka hyrë si investitor jo me 114m², por me mbi 2500 m² tokë.²³

16.2. Për të njëjtin qëllim ata kanë fshehur 350 kontrata shitje, vetëm gjatë viteve 2010-2011, të apartamenteve dhe dyqaneve, që në grupë, me një çmim 20% më të ulët se tregu, që mundësuan që projekti të bëhej i vetë-financueshëm.²⁴

17. Prokurorët nuk referojnë Vendimin e Këshillit Bashkiak, nr. 57, datë 24.12.2012, që miratoi Planin e Përgjithshëm Rregullues së Tiranës, i cili parashikonte edhe ndërtimin e një shkolle tek toka që pronarët e lanë “VAKËF”.²⁵

17.1 Këtë tokë, me vlerë 1, 2 milion euro, që pronarët fisnik e kishin lënë për ndërtim shkolle të mesme për komunitetin, Edi Rama ia dha me akte antiligjore, për një euro, mikut të tij Karlo Bolino, duke firmosur për këtë qëllim 4 vkm të personalizuar.²⁶

18. Prokurorët e SPAK gënjyen me qëllim kur thanë se klubet sportive funksiononin normalisht në vitin 2008. Formularët e fshehur nga SPAK, që

²¹ [Aneksi 21: Pamja 33](#)

²² [Aneksi 22: Pamja 34](#)

²³ [Aneksi 23: Pamja 35](#)

²⁴ [Aneksi 24: Pamja 36](#)

²⁵ [Aneksi 25: Pamja 37-38](#)

²⁶ [Aneksi 26: Pamja 39](#)

mbajnë firmën e Edi Ramës, tregojnë se asokohe, thuajse të gjithë objektet ishin zënë forcërisht.²⁷

18.1. Zv.Ministri i Sporteve në 2006, me shkresën nr. 6714/1, datë 03.08.2006, shkruan se Ministria e tij nuk kish mundur ta merrte në inventar Klubin Shumësportësh Partizani, pasi ai ishte i uzurpuar nga familje informale.²⁸

18.2 Sipas Drejtorit të Komandës Mbështetëse, Ministria e Mbrojtjes as nuk e posedonte dhe as e administronte ish Klubin e Futbollit Partizani. Grupi i punës që ai dërgoi u përzu me forcë nga uzurpatorët.²⁹

18.3 Prej vitesh shteti nuk fitonte asnjë qindarkë nga klubet sportive Partizani, pasi territori dhe ndërtesat e tij ishin të pushtuara në mënyrë të paligjshme nga mbi 42 familje informale dhe subjekte që zhvillonin aktivitet informal ndërsa pronarët e tokës sorrollateshin e nuk gëzonin pronën e ligjshme të tyre.

19. Prokurorët kishin fshehur kontratën e familjes Begeja sipas së cilës të gjithë anëtarët e saj kishin të drejtë të investonin në zhvillimin e pronës deri në 25% të pjesës së tyre takuese.³⁰

20. Vështirësitë e krijuara nga presioni politik, si dhe uzurpimi i pronës bëri që vetëm Prof. Malltezi dhe dy bashkë-pronarë të tjerë të binin dakort të bashkëinvestonin për zhvillimin e pronës.

20.1. Në fillim, për periudhën 2008-2014, ata e formalizuan marrëdhënien e tyre ligjore me kontratë të noterizuar, ekzistencën e të cilës prokurorët e injoruan me keqdashje.³¹

21. Për periudhën 2014 e në vazhdim, ata e kthyen marrëdhënien e tyre në formatin e një shoqërie tregtare dhe rregjistruan pjesmarrjen e tyre në të me shkrim, sipas detyrimeve ligjore.³²

²⁷ [Aneksi 27: Pamja 40](#)

²⁸ [Aneksi 28: Pamja 41](#)

²⁹ [Aneksi 29: Pamja 42](#)

³⁰ [Aneksi 30: Pamja 43](#)

³¹ [Aneksi 31: Pamja 44](#)

³² [Aneksi 32: Pamja 45](#)

21.1. Si në periudhën e organizimit kontraktor, ashtu edhe si shoqëri tregtare, aktiviteti i tyre, si dhe vetë investitorët, shlyen çdo detyrim tatimor dhe bënë çdo deklaram që ishte detyrim ligjor, pranë organeve përkatëse publike.

Si konkluzion

22. Njohja, kthimi i pronës dhe privatizimi i objekteve të rrënuara të klubit Partizani janë zhvilluar në përputhje të plotë me ligjet. Pronarët legjitimë kanë marrë pronën e tyre të konfiskuar 60 vite më parë dhe shteti nuk ka pësuar asnjë dëm.

23. Asnjë zyrtar, i asnjë qeverie, qe kanë firmosur dokumenta të këtij procesi nga viti 1995 deri në 2009, nuk është në ndjekje penale, sepse ata kanë zbatuar strikt ligjin.

24. Prof. Malltezi ka marrë sipas ligjit 410m² tokë pronë të familjes tij, nga 1,577,400,000m² që morën mbi 500,000 pronarë vetëm gjatë viteve 2006-2012.

24.1. Tokën që familjet pronare e lanë për ndërtim shkolle për komunitetin, përfshirë edhe 1,500m² tokë të familjes Begeja të Prof. Malltezit, Edi Rama ia dha mikut të tij Bolino me 1 euro, duke firmosur për këtë qëllim 4 VKM të personalizuar, në kundërshtim me ligjin.

25. Ndryshimi i destinacionit të terrenit, si e drejtë ligjore ekskluzive e qeverisë vendore, është bërë nga Edi Rama para privatizimit. Privatizimi i ndërtesave të rrënuara të Klubit nisi nga qeveria Nano dhe përfundoi sipas ligjit nga qeveria Berisha.

26 Dosja e Klubit Partizani është një piramidë mashtrimi politik, e ngritur mbi kallzimin e rremë të lidërshipt socialist dhe shpifjet, fshehjen e qindra dokumentave dhe manipulime të SPAK, me porosi të Edi Ramës, për të goditur politikisht Sali Berishën dhe Partinë Demokratike.

27. Ndërkohë që është vetëm nën hetim, Sali Berisha është vendosur nën tre masa sigurie, tipike të një diktature, ndonëse në asnjë dokument të këtij procesi nuk

ekziston firma e tij dhe nuk ka asnjë dëshmi për ndërhyrje apo presion nga ana e tij ndaj ndonjë personi.

28. Ndalimi i çdo komunikimi përveçse me familjarët e ngushtë për Berishën nga prokuroria, gjykata dhe parlamenti, në kontroll të plotë të Edi Ramës, bie ndesh me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 17 të kushtetutës së Shqipërisë sipas të cilit kufizimi i të drejtave themelore kushtetuese bëhet vetëm me ligj.

29. Prof. Malltezi u arrestua brutalisht dhe më pas u la në arrest shtëpie dhe ju sekuestruan pasuritë, si person në hetim, për fajin e vetëm se është dhëndri i Sali Berishës. Ai u burgos për pronën e tij, njësoj si komunistët burgosën dhe pushkatuan paraardhës të tij që prej vitit 1945 për shkak të përkatësisë klasore dhe pronave të tyre.

30. Për të montuar këtë dosje, Edi Rama zgjodhi persona në konflikt të hapur interesi, të larguar nga Berisha prej detyrës si ish oficeri i policisë sekrete të Hoxhës, si e korruptuar, apo të denoncuar prej tij për lidhjet me krimin.

31. Këto masa u morën sepse, me rikthimin e Berishës, pas shpalljes së tij non-grata nga departamenti i Shtetit dhe Home Office për korrupsion, pa asnjë fakt apo provë të vetme, por vetëm mbi lobimin korruptiv të mentorit të Ramës – George Soros, e McGonigal, Rama humbi kontrollin e tij mbi opozitën.³³

32. Rama ndërmori këto masa pasi opozita nisi protesta kundër bllokimit nga ai të hetimit të tij parlamentar, për skandalin McGonigal dhe aferat korruptive shumë miliardëshe si ajo e inceneratorëve, Dubai City i Durrësit e dhjetra PPP-ve që mbajnë firmën e tij.

33. Ai ndërmori këto masa pasi opozita denoncoi lidhjet e tij direkte me kartelet e drogës në Shqipëri e rajon, me bosët shqiptarë të Sinaloas të Meksikës, me shpalljen e tyre investitorë strategjikë, si dhe bisedat me Sky ECC me organizatat kriminale.³⁴

³³ Raporti me të vërtetat rreth shpalljes non grata të Sali Berishës, mund të shkarkohet këtu: <https://www.sali-berisha.com/>

³⁴ Aneksi 33: Pamja 46-47

34. Ne vendosjen e këtyre masave ka ndikuar procesi gjyqësor i McGonigal për dosjen shqiptare që zhvillohet në shkurt në Washington, e cila tregon se Edi Rama McGonigal, Dorian Duçka dhe Agron Neza kanë vepruar si grup i strukturuar kriminal.³⁵

35. Nga 2017 deri në 2020, ky grup, në Tiranë dhe rajon, u kanë vendosur gjopa shumë milionëshe biznesmenëve me shantazh/premtim të vënies/ heqjes nga listat e zeza të qeverisë së SHBA.

35.1. Mc Gonigal, ish kreu i Kundër-zbulimit të FBI për Neë York, u pagua nga Rama, përmes ish agentit të Sigurimit të Shtetit A. Nezaj, me 225,000 dollarë për të dëmtuar opozitën në Shqipëri dhe për shpalljen e Berishës non-grata³⁶

36. Rikthimi i Berishës i shkatërroi Edi Ramës, kreut të narkoshtetit të parë dhe të vetëm në Europë, ëndrrën për një Shqipëri pa opozitë apo me opozitë të kontrolluar prej tij dhe për një mandat të ri të bazuar në grabitjen e zgjedhjeve.

37. Me këtë akt, Edi Rama tregoj se është pasardhës besnik i babait të tij, Kristaq Ramës, zëvendesit të Ramiz Alisë dhe Nexhmije Hoxhës, që më 8 gusht 1988 firmosi varjen publike në litar të poetit Havzi Nela, për vargjet e tij për fjalën e lirë.³⁷

38. Për gjithë arsyet e mësipërme, Edi Rama më 9 Prill dhe 7 Maj 2022, përkatësisht në Kongresin dhe Asamblenë e PS, i kërkoi publikisht SPAK të procedojë Sali Berishën që ishte shpallur non-grata. Prokurorët politikë zbatuan urdhërin e tij.

³⁵ [Aneksi 34: Pamja 48-49](#)

³⁶ [Aneksi 35: Pamja 49/1 Burimi:https://tts-bild-prod.podigee.io/7908-russen-oligarch-albanien-premier-sex-ol-und-dubiose-gelder-korrupter-fbi-agent-balkan-beben-bis-berlin](https://tts-bild-prod.podigee.io/7908-russen-oligarch-albanien-premier-sex-ol-und-dubiose-gelder-korrupter-fbi-agent-balkan-beben-bis-berlin)

³⁷ [Aneksi 36: Pamja 50](#)

Aneksi 1

PROCESVERBAL

KRAJA NE 1990 DENON TE RIUN PER SHKELJE MORALIN KOMUNIST

Per ndalimin e Beniamin Bizi
Sot me datën 27.7.1990 ora 10.30 në Shkollën
Shkollën "Lidon Kresh" në mbledhje të nivelit 68 të K. Pr. Penale
nga Beniamin Bizi bërë ndalimin e Beniamin Bizi
i biri Ilir dhe i Yllir lindur në Shkodër, i dt. 1964
dhe banues në rr. "Kombi" Nr. "K. To Vegj" 72 me profesion punëtor në SHT
me arsim 8 klasë parti jo, taktë i ngjadhur
në organet e pushtetit jo i dënuar jo
i pajtur me pasportën Nr. _____ Seria _____ lëshuar me datën _____
nga _____
Ndalimi i të përmendurit u bë për arsye se: me datën 26.7.1990 në bashkë
punë me persona të tjerë kanë shkruar në qytetin e Tiranës, ku kanë krye
veprimet e bërë në kundërshtim me normat e moralit komunist.

Vepza penale për të cilin u bë ndalimi parashikohet nga neni 129 e 13 i K.P.
Ky procesverbal u përpilua në tri kopje prej të cilave një do të vendoset në dosjen
normale, një i dorëzohet të ndaluarit dhe e treta i jepet për shprehjen e izolimit.

INDALUARI
Beniamin Bizi
(B.B.)

HEMBESI
Arben Kreja
(Arben Kreja)

Figura nr.1

Aneksi 2





Figura nr.2

Aneksi 3



87
ME TE NJEJTEN DATE 01.12.2020
RREGJISTROHET EDHE KALLZIMI PENAL EDHE
PROCEDIMI PENAL

Tiranë, më 17.11.2020

KALLËZIM PENAL

KALLËZUES:

Taulant Balla
Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKTI:

Kallëzimin e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës“ në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 248-25 i Kodit Penal, të “Ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” në bashkëpunim parashikuar nga neni 145/1-25 i Kodit Penal, të “Falsifikimit të dokumenteve” të parashikuar nga Neni 186 i Kodit Penal, të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” në bashkëpunim të parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal, të “Korrupsionit aktiv/pasiv në sektorin privat” sipas nenit Neni 164/a/b të Kodit Penal.



KUNDËR:

Sali BERISHA - ish-Kryeministër gjatë viteve 2005-2013

Arben IMAMI - ish-Ministër i Mbrojtjes 2009-2013

Anëtarë të tjerë të Këshillit të Ministrave 2005-2013

Figura nr.3 (vijon në faqen tjetër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

**PROCEDIMI MBI BAZEN
E KALLZIMIT TE RREME
NGA T. BALLA**

URDHËR
PËR
RREGJISTRIMIN E PROCEDIMIT PENAL

Në Tiranë, më datë 01.12.2020, unë **Enkeleda Millonai**, prokurore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pasi studjova kallzimin penal nr. 246 të vitit 2012,

KONSTATOVA

Shtetasi Taulant Balla ka paraqitur kallzim penal duke pretenduar se janë kryer disa vepra penale nga funksionarë të lartë. Veprat penale që pretendohet se janë kryer janë ato të shpërdorimit të detyrës në bashkëpunim, ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike në bashkëpunim, falsifikimi i dokumentave, pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, korrupsioni aktiv dhe pasiv në sektorin privat.

Konkretisht parashtrohet se prej vitit 2012 e në vazhdim, kallzuesi ka denoncuar në median e shkruar dhe atë vizive një aferë korruptive të tjetërsimit të pronës shtetërore, Klubi Sportiv Partizani, filluar privatizimi gjatë vitit 2008.

Sipas kallzuesit, ndër çështjet që evidentohen dhe që sipas tij, formësojnë elementët e veprave penale të kallzuara, kanë të bëjnë me faktin se trajtimi i dosjeve të familjeve të vetëquajtura ish pronare, është bërë brenda një afati pothuaj disa mujore, si procedura e njohjes dhe kthimit të pronës. Sipas kallzuesit, përdorimi i termit të vetëquajtura apo gjasme ish pronare, lidhet me faktin se bazuar në dokumentat arkivore ka dyshime se 80 vite më parë, pronarët janë dëmshpërblyer me franga ari nga qeveria e asaj kohe (viti 1940) dhe ky fakt nuk është marrë parasysh nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Sipas kallzuesit, pronarët janë shpronësuar nga Italia Fashiste, e cila kishte planifikuar të ndërtonte një aeroport. Toka është blerë nga Shefqet Verlaci dhe Jako Mane. Toka nga Rruga e Kavajës deri tek Rruga e Durrësit është blerë nga italianët dhe më pas ka kaluar në duart e shtetit. Për këtë arsye ngrihen dyshime mbi ekzistencën e veprës penale të falsifikimit të dokumentave dhe shpërdorimit të detyrës. Këto anashkalime nga Komisioni i Kthimit të Pronave sipas kallzuesit, kanë ndodhur për shkak se dihej kush do të ishte përfituesi i tyre e konkretisht përfitues do të ishte shtetasi Jamarbër Maltezi.



Figura nr.4

Aneksi 4

2. Në aspektin penal

Vlerësoj se të kallëzuarit nga ana ime apo edhe persona të tjerë siç mund të jenë dhe ish funksionarët e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kanë konsumuar elementë të veprës penale të "Shpërdorimit të detyrës" në bashkëpunim, parashikuar nga Neni 248-25 i Kodit Penal, "Ushtrimi ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike" në bashkëpunim parashikuar nga neni 145/1-25 i Kodit Penal "Pastrimit i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale " në bashkëpunim parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal.

Shpërdorimi detyrës qëndron në faktin se pronarët e rinj të tokës ku ndodheshin objektet e Ushtrisë, janë shpronësuar një herë nga Italia fashiste, e cila kishte planifikuar të ndërtonte një aeroport. Madje toka është blerë nga Sheqet Vërlaci dhe Jako Mane. Toka, nga Rruga e Kavajës deri tek Rruga e Durrësit është blerë nga italianët dhe më pas ka kaluar në duart e shtetit. Pra, pretendentët e këtyre pronave janë kompensuar një herë nga italianët dhe më pas toka është shtetëzuar, duke i kaluar në pronësi Ushtrisë.

Këto veprime ngrenë dyshime të arsyeshme për t'u ndodhur para elementëve të veprës penale të shpërdorimit të detyrës.

.....
parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal të parashikuar nga nenet 248-25, 245/1-25, veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve" të parashikuar nga Neni 186 i Kodit Penal "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale " në bashkëpunim parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal. "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale "në bashkëpunim parashikuar nga neni 287-25 i Kodit Penal, 287-25 i Kodit Penal nga ana e funksionarëve publik me qëllim tjetërsimin e pronës shtetërore, si dhe të "Korrupsionit aktiv në sektorin privat" sipas nenit Neni 164/a/b të Kodit Penal.

Me respekt,

**KALLZIMI I RREME I T. BALLE QE
JAKOMONIN E NJEH SI JAKO MANE**

KALLËZUESI

Taulant Balla

Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste




Figura nr.5

Aneksi 5




Figura nr.6 (vijon në faqen tjetër)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
I P Ò T E K A

Tiranë, më 23 shkurt 1995

Begeja 652

3

VERTETIM PRONËSIE

Në regjistrimin ipotekar Nr. 299 datë 11.4.1935 në favor të Mahmut e Xhemal Begeja, figurën e regjistruar një tokë prej katërmbëdhjetë (14) dylm e ndodhur në shtetin Shëngjine të Tiranës, që kufizohet : në lindje me rrugën e korit, nga perëndimi me Mahmut Begeja dhe vllazërit, nga veriu me Ramazan Dallan, nga juga me headekun e Biqirajës, të zotuar në bazë të aktit të Njortunisë së Gjyqit të Paqit të Tiranës me Nr. 35 dt. 11.4.1935.

Në krahasim të kësaj transkriptimi ndodhet transkriptimi Nr. 256 dt. 24.3.1943 ku thuhet se në favor të Xhemal Begeja ndodhet një kërkesë përfundimtare për pjestim pasurisë.

*nga R. Deliu
7.1X.95
Vertetimi i pronësisë
është i përfunduar
Hend*



Nëpunësja e Ipotekës
Etleva

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DITËJA SHQIPËRE
TIRANË
Në datën 01.03.1995
VERTETIMI DE KËM FOTOKOPIJE
ENATË E ...

NOTERE
SHEKENDIE BRAHA
Shek

**PRONA E BLERE NE 1935 KA VIJUAR
E PANDERPRERE DHE NE 1943
VELLEZERIT NISEN PROCES CIVIL
PER PJETIM TE PASURIVE TE TYRE**



Figura nr.7 (vijon në faqen tjetër)

VERETIMI PRONESIE

IPOTEKA 1945 - TOKA E D. VAQARI KUFIZOHET NE JUG ME TOKEN E VELLEZERVE BEGEJA

Në regjistrin ipotekar me Nr. 327, datë 8.II.1945, në pronësi të Dylbere Vaqarit, figurues dy të dhjetat e katërxqindzetësh pasurisë së Ruzman DEJ në Janë: I- Një shtëpi në gjendje të këqijë në lagjen e Pe të Tiranës e cila përmbledh dy kulla dhe sallën malte, dy oda e sallën poshte, gjelitero, obor dhe pus me vete. Kjo shtëpi aktualisht kufizohet: lindja pjesërisht me shtëpinë e Sabrije Llagamit dhe pronën e Haxhi Gjokës, perëndim me ruginë e shtëpiave të Mehmet Deliu të veri me truallin e Mehmet Haxhi dhe me ruginë e portës, dhe jugu me oborin e shtëpisë së Mehmet Eliut dhe pjesërisht me oborin e shtëpisë së Sabrije Llagamit. shënim i shtetit Nr. 259/1957.

Një copë toke e ndodhur në lagjen e re të Tiranës, në sinorin Shengjine e e cila aktualisht kufizohet: lindja me token e Rexhep Alimetit, veri me ruginë e Krijit të Shengjines, jugu me token e vellezerve Begeja dhe nga perëndimi me token e ka marrë për pjesë Sabrije Llagamit. Një tokë ka një sipërfaqe 14120 (katërbodhjetë mijë e njëqind e njëzetë) metra katrorë.

Në krah të këtij transkriptimi ndodhet transkriptimi me Nr. 259/48, datë 30.7.1957.

origjinali i folës Hilata vicia

*Veretimi i pronësive
është i rregullt*

[Signature]

NEPUNESI I IPOTEKES
ETLEVA BEGA



[Signature]

Figura nr.8 (vijon në faqen tjetër)

668
IPOTEKA 1945 TOKA LLAGAMI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
- I P O T E K E -

**JUGU KUFIZOHEJ ME
TOKEN VELL. BEGEJA**

VËRTETIM PRONËSIE

Në regjistritin ipotekor Nr. 329 datë 3 Nëntor 1945, në pronësi të Sabrije Llagamit, bashkëshorte e Hamdi Llagamit dhe e bija e Ramezan Deliu, figuron të regjistruara për 2/10 pjesë në dhjetë pjesë të saja, këto prona : një shtëpi e ndodhur në lagjen e Re të Tiranës, në rrugën e Kavajës Nr. 81 e cila përmbledh dy oda e një sallën në vehte di dhe një shtëpi, një odë një qur, hajat, oborr para e mbrapa, një magazë, nevojtare e gjysëm pusi. Këto prona duke formuar një bllok në vehte kufizohen: Lindja me shtëpinë e Kasem e Beqir, të birt e Ismail Seferrit, nga jugu me kopshtin e Frano Leshit, Perëndimi me oborritin e shtëpisë së Mehmet Deliu dhe pjesërisht me pronat e Dylbere Vaqarrit dhe nga Veriu me shtëpinë e Antigonit Kojës e cila në parë ishte e Kost e Vangjel Laskut dhe me rrugën private që ka kryesh në shetitaren e Kavajës.

Një copë tokë ndodhur në lagjen e Re të Tiranës, në sinorin Shëngjine, e cila aktualisht kufizohet : Lindja me tokën që ka marrë për pjesë Dylbere Vaqarri, Perëndimi me tokën e Ismail Haxhi Puçlumbit, nga Veriu me rrugën e Kroit të Shëngjinit dhe nga jugu me tokën e vëllezërve Begeja. Kjo tokë ka një sipërfaqe prej metra katrorë 14120 (katërmbëdhjet mijë e njëqind e njëzet) dhe zotërohet në bazë të tapisë Nr. 2 D 1 Marrë 323 allaturka. Gjithashtu Sabrije Llagami për 2/10 pjesë në dhjetë pjesë që zotëronte të ardhura trashëgimisht nga i ati saj dhe për 3/10 pjesë në dhjetë pjesë që kjo ka të bleme prej Mehmet e Merjeme Deliu. Shuma e pjesëve bëhet 5/10 pjesë në dhjetë pjesë në dy copë toka, të ndodhura në sinorin Shëngjine të Tiranës, me emrin Nallbane, dhe mbas pjestimit që ka bërë ka marrë si pjesë në vehte një copë tokë me dimensionet : Lindja me një ball prej 69.⁶⁰ (gjashtëdhjet e nëndë e 60%) me hajdar Loçen, Perëndimi me një ball prej 111.⁵⁰ (njëqind e njëmbëdhjetë e 50%) metra me pjesën që marrën për pjesë Zoje Alimehmeti, Dylbere Vaqarri dhe trashëgimtarët Mehmet Deliu, Veriu me një ball prej 125.¹⁰ (njëqind e njëzet e pesë e 10%) metra me hendekun e Beqir Agës me një ball prej 108.⁴⁰ (njëqind e tetë e 40%) me rrugën private të metra të gjërë e të shkëputur nga prona e përzgithëshme e destinuar për kalim të

Figura nr.9

datë 6.3.1940 XVIII, mënyrë që ligji Nr. 204 datë 12.7.1940 XVIII.

Mbasit u pa omni 2 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 1 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 2 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 1 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 2 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 1 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 2 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 1 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 2 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

Mbasit u pa omni 1 i Dekretit Mbrojtësor Nr. 294 datë 12.3.1943-XXI që i jep Qeverinë Mbrojtëse Shqiptare me shiri ngjashmëri e ligjvënës shqiptare në Total e Ligjvënës.

